

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit Xh.K., për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së, duke vendosur, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga i dënuari Xh.K., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.1557/2015 të datës 20.11.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.118/2018 të datës 07.03.2018, në seancën e kolegjit, të mbajtur më 3 gusht 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit Xh.K. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.1557/2015 të datës 20.11.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.118/2018 të datës 07.03.2018.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin P.nr.1557/2015 të datës 20.11.2017, të dënuarin Xh.K., e ka shpallur fajtor për veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari brenda afatit prej 1 (një) viti pasi që aktgjykimi merr formën e prerë nuk kryen veprë tjetër penale. Në emër të paushallit gjyqësor është obliguar që ta paguajë shumën prej 30€, kurse i dëmtuari nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.118/2018 e datës 07.03.2018, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën dhe të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me parashtrësën KMLP.II.nr.129/2018, e datës 18.07.2018, ka propozuar, që kërkesa e të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, theksohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë bazohet vetëm në dëshminë e të dëmtuarit T.K. dhe se kjo dëshmi nuk ka qenë e mjaftueshme për tu shpallur fajtor, për më tepër, pa asnjë bazë ligjore gjykata e shkallës së parë ka refuzuar propozimin e të dënuarit që në shqyrtimin gjyqësor të dëgjohen dëshmitarët e propozuar të cilët do të sqaronin rastin pasi që nuk bëhet fjalë për uzurpim por mosmarrëveshje.

Pretendohet se po të dëgjoheshin dëshmitarët e propozuar me siguri se do të vërtetonin se i dënuari nuk ka kryer këtë vepër penale meqë ka pasur marrëveshje mes të të dënuarit dhe të dëmtuarit, mirëpo këtë marrëveshje i dëmtuari po e fsheh. Gjykata me rastin e vendosjes i ka besuar vetëm të dëmtuarit, aktvendimit për ndarjen e pasurisë së trashëguar dhe fletës poseduese e që realiteti është më ndryshe pasi që dëshmitarët e propozuar do të vërtetonin faktin se mes të

dënuarit dhe të dëmtuarit ka pasur mosmarrëveshje përkitazi me ndarjen e pasurisë dhe se ndarja e bërë ka qenë vetëm për çështje të biznesit dhe nuk ka qenë ndarje de jure.

Në kërkesë më tutje, theksohet se vendimi mbi dënimin është i paqëndrueshëm pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se i dënuari ka kryer këtë veprë penale, përkatësisht nuk plotësohen elementet e kësaj veprë penale. Pasi që për tu kryer vepra penale e uzurpimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme duhet që në pronë të hyhet me forcë dhe të mbahet me forcë apo kërcënim e që këto nuk kanë ndodhur, andaj, këto që u ceken e bëjnë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë të paqëndrueshëm.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Nuk është i bazuara pretendimi i paraqitur në kërkesë, se aktgjykimi i shkallës së parë, është marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur fakte të plota dhe të qarta dhe në mënyrë të detajuar janë arsyetuar të gjeturat e gjykatës. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë të gjitha faktet janë vërtetuar në mënyrë të plotë dhe për secilin fakt janë paraqitur të dhëna të arsyetuara në secilën pikë të aktgjykimit dhe janë dhënë arsyetime lidhur me faktet e vërtetuara dhe të pavërtetuara. Po ashtu në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, është dhënë arsyetim i mjaftueshëm përkitazi me refuzimin e propozimit për dëgjimin e dëshmitarëve. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se arsyeja e këtij propozimi ka qenë zvarritja e procedurës penale dhe se bazuar në provat e prezantuara mjaftueshëm është shtjelluar kjo çështje penale. Posaçërisht theksohet se bazuar në dëshminë e të dëmtuarit dhe provave materiale dhe atë aktvendimit për ndarjen e pasurisë së trashëguar pas vdekjes së babait të të dëmtuarit e evidentuar T.nr.162/04 e datës 20.07.2004 dhe certifikatës për të drejtat pronësisë nr.220/15 e datës 20.02.2015, është vërtetuar se pronar i kësaj paluajtshmërie është i dëmtuari. Për më tepër, këtë nuk e konteston edhe vet i dënuari por aludon në

marrëveshjen që ka pasur me të dëmtuarin. Mirëpo, këto pretendime nuk janë faktuar me asnjë provë në instancën e gjykatës së shkallës së parë e as në instancën e gjykatës së shkallës së dytë e për më tepër, nuk janë paraqitur argumente as në kërkesën e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Po ashtu edhe pretendimi tjetër i paraqitur në kërkesë, se nuk janë plotësuar elementet e veprës penale të uzurpimit të pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së, pasi që hyrja në lokal nuk është bërë me forcë dhe po ashtu nuk është përdorë forcë apo kërcenim gjatë qëndrimit në të, është pretendim i pabazuar. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në veprimet e të dënuarit janë formësuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale uzurpimit të pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së, meqë i dënuari për një kohë të gjatë në periudhën kohore nga viti 2010 deri në muajin maj 2017, në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar pronën e të dëmtuarit. Ashtu që për tu realizuar elementet e kësaj vepre penale mjafton që uzurpimi të jetë i kundërligjshëm siç ka qenë rasti në fjalë dhe nuk është e nevojshme që të përdoret forca e as kanosja gjatë hyrjes e as gjatë qëndrimit në pronën e uzurpuar siç pretendon i dënuari.

Edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, megjithatë bazuar në përmbajtjen e kërkesës, janë paraqitur pretendime për konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo, e këto pretendime nuk janë vlerësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, meqë bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishe e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.176/2018, më 3 gusht 2018

Bashkëpunëtori profesional,

Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,

Valdete Daka